

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. 1850 REP.
NR. 769 REP.



KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot me datë 20/12/2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), para meje noteres publike Xhoana Omari, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë noteriale në adresën Rr. "Mine Peza", Pall. 83/1, Kati 1 ne krah te Ambasades Polake u paraqitën palët:

Z. Ergys Halili, atësia Hajri, datëlindja 29.11.1972, lindur dhe banues në Tiranë, rruga "Abdyl Frashëri", pall 8, shk.1, ap. 67, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi me nr 028351594 dhe nr. personal G81102102F madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i vetëm i shoqërisë NCI shpk, (i cili këtu e më poshtë do të quhet **SHITËSI**);

DHE

BLERËSI: Z. Besnik Halili, atësia Hajri, datëlindja 02.11.1968, lindur dhe banues në Tiranë, rruga "Abdyl Frashëri", pall 8, shk.1, ap. 67, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi me nr 028351594 dhe nr personal G81102102F madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, (i cili këtu e më poshtë do të quhet **BLERËSI**);

DUKE QENË SE:

Z. Ergys Halili është ortak me 100% të kuotave të kapitalit në shoqërisë NCI shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në QKR me NUIS L41709011G, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", kullat binjake, kulla nr.2, kati 5, zyra A2, Tiranë, palët lidhin këtë kontratë me kushtet si më poshtë:

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "NCI" shpk të zotëruara nga Z. Ergys Halili, në favor të Z. Besnik Halili.

NENI 2 CMIMI I SHITJES

- 2.1 Cmimi total i shitjes së kuotave të zotëruara nga shitësi tek blerësi do të jetë 1.000.000 lekë.
- 2.2 Shlyerja e vlerës së mësipërme do të kryhet plotësisht nga blerësi Z. Besnik Halili.

NENI 3 KALIMI I TITULLIT TË PRONËSISË

- 3.1 Kalimi i fitimit të pronësisë dhe fitimi i pronësisë bëhet nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij Neni.

(Signatures of the parties and the notary)

3.2 Shoqëria e regjistron kalimin e kuotës sipas Nenit 43 të Ligjit "Për qendrën kombëtare të regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

3.3 Një kopje e kësaj kontrate shitje do të depozitohet menjëherë pranë QKB në mënyrë që të bëhet kalimi i menjëhershëm i kuotave në pronësi të blerësit. Për depozitim të kësaj kontrate pranë QKB autorizohet **Z.Gerti Idrizi** me kartë identiteti 031461794 / I21229051W

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

- 4.1 Shitësi merr përsipër të njoftojë, garantojë dhe sigurojë blerësin se deri në momentin e lidhjes dhe të nënshkrimit të kontratës këto kuota:
- Nuk janë proces falimentimi, likuidimi apo të bllokuara për llogari të të tretëve
 - Shitësi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë që të kenë pretendime në lidhje me këto kuota.
- 4.2 Dokumentacioni bashkëngjitur kësaj kontrate është ligjor, origjinal dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo i falsifikuar.
- 4.3 Shitësi nuk ka detyrime të papaguara në favor të të tretëve.
- 4.4 Shitësi është i detyruar të paguajë detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga blerësi. Shpenzimet e tjera bëhen nga palët sipas parashikimeve të Kodit Civil.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, blerësi do të paguajë çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zotëron në shoqëri, detyrime ndaj të tretëve, shtetit, etj..

Blerësi ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate..

Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë të palëve.

NENI 6

ZGJIDHJA E KONTRATËS

Palët nuk mund të zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur ka mospërbushje të detyrimeve kontraktore.

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në kontratë në mënyrë të njëanshme. Për çdo problem që mund të lindë apo ndryshim i domosdoshëm i kontratës i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëri tjetrin në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakort mund të realizojnë ndryshime në kontratë.

NENI 7

INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

H

SS

Maus

Cdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

NENI 8

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Kjo kontratë shitje me objekt shitje kuotash është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil si dhe Ligji 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë.

NENI 9

NJOFTIMET

Cdo njoftim, kërkesë, apo cdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkruara në këtë kontratë, duke patur parasysh që të dërgohen sa më shpejt.

NENI 10

GJUHA E KONTRATËS

Kontrata hartohet në tre kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Unë, noterja publike Xhoana P. Omari Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time të noterisë me adresë në Rrugen "Mine Peza", pasi i lexova me zë të lartë tekstin e kësaj Prokure të Posacme Z. Besnik Halili dhe Z. Ergys Halili, të cilët u njohën me përmbajtjen e saj në praninë time dhe pasi e gjen atë në përputhje me vullnetin e tij të plotë e të lirë, e nënshkruan rregullisht, po në praninë time dhe unë noterja e vërtetoj këtë dokument sipas ligjit.


SHITËSI

Ergys Halili

ERGYS HALILI 

Jep Pelqimin

Vasilika Mano

Vasilika Mano 

BLERËSI

Besnik Halili

Besnik Halili 





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20161229102011250
Data e Rezultatit të Kerkimit: 29.12.2016
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 10:20:11AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-675-73
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0



Signature

Regjistri i Barrëve Siguruese



Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

FATURË

Emri i Perdoruesit:

DHURATA
MUSTAFA
VARDHAMI

Adresa:

RR. BOGDANI, OBJEKTI EUROKOL, KATI II, AP. 5
TIRANE-TIRANE
SHQIPERI

Nr. i Llogarise:

400-675

Date:

29.12.2016

Pershkrimi:

D-20161229102011250

Balanca Perpara:

Leke 4,200.00

Debi

Leke 1,400.00

Balanca Aktuale:

Leke 2,800.00

Komente:

